



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 283, datë 19.12.2019

**Për plotësimin e 3 (tre) pozicioneve në Prokurorinë e Përgjithshme përmes
procedurës së komandimit të prokurorëve**

Mbështetur në nenin 53, nenin 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 176/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

Neni 1

Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 3 (tre) pozicioneve në Prokurorinë e Përgjithshme përmes procedurës së komandimit të prokurorëve, konkretisht për pozicionin e: a) Drejtorit të Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm, b) Drejtorit të Drejtorisë të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Dekriminalizimit, si dhe c) pozicionit të specialistit/ ndihmësmagjistratit në Drejtorinë e Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore.

Neni 2

Afati i komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet.

Neni 3

Ftohen të gjithë prokurorët e shkallës së parë dhe të dytë që nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar (në KLP ose SPAK) dhe që nuk janë të komanduar në një pozicion tjetër që të shprehin interesin për t’u komanduar në njërin nga pozicionet e nenit 1.

Neni 4

Shprehja e interesit duhet të bëhet jo më vonë se 2 (dy) javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa”, nr.1 Tiranë.

Mbi zarf duhet të shënohet: “Shprehje Interesi për Komandim”

Shprehja e interesit duhet të përmbajë arsyet e kandidatit për kandidimin (jo më shumë se 2 faqe A4) duke specifikuar se për cilin pozicion kandidohet si dhe një CV e përditësuar.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

